

VENDIM
Nr.245, datë 6.3.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DHIVËR, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dhivër, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Dhivër, të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.732, datë 7.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dhivër, të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Dhivër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dhivër

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
17-19	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
20-25	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
26-41	Varrezat publike	Në pronësi
42-68	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik	Në pronësi
69	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në mbrojtjen civile	Në pronësi
70,85	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
103-110	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
225-234	Infrastrukturë (rrugë vendore).	Në pronësi